

Popullsia e Shqipërisë

1 Janar 2015

Tiranë, më 13 Shkurt 2015: Popullsia e Shqipërisë më 1 Janar 2015 arriti në 2.893.005 banorë duke pësuar një rënie prej 2.942 banorësh, krahasuar me atë të 1 Janarit 2014.

Nga kjo popullsi, 1.462.005 janë meshkuj dhe 1.431.000 janë femra. Raporti gjinor i popullsisë së Shqipërisë është 102,1 meshkuj për çdo 100 femra. Mosha medianë e popullsisë së Shqipërisë në 1 Janar 2015 është 35 vjeç.

Ngjarjet demografike dhe ndikimi i tyre në ndryshimin vjetor të popullsisë.

Lindjet. Gjatë vitit 2014 numri i lindjeve në Shqipëri ka qenë 35.760, nga të cilët 18.683 ishin meshkuj dhe 17.077 ishin femra. Raporti gjinor në lindje për vitin 2014 ishte 109,4 meshkuj për çdo 100 femra. *Vdekjet.* Gjatë vitit 2014 në Shqipëri kanë ndodhur 20.656 vdekje, nga të cilat 11.111 ishin meshkuj dhe 9.545 ishin femra. Shtesa natyrore për vitin e kaluar ka qenë 15.104 persona. *Emigrimi.* Në vitin 2014, u vlerësua të jenë larguar nga vendi 46.413 persona ku 52 % e zinin meshkujt. *Imigrimi.* Në të njëjtin vit numri i imigrantëve në Shqipëri u vlerësua të jetë 28.367 persona. Migracioni neto gjatë vitit të kaluar ka qenë – 18.046. Rrjedhimisht popullsia e Shqipërisë ka pësuar një rënie prej 2.942 personash (15.104 shtesa natyrore -18.046 migracioni neto).

Ndryshimet vjetore të komponentëve demografikë: Gjatë vitit 2014 numri i lindjeve dhe ai i vdekjeve mbeti pothuaj i njëjtë krahasuar me vitin 2013. U regjistruan vetëm 10 lindje dhe 214 vdekje më shumë. Gjatë vitit 2014 migracioni neto në Shqipëri në krahasim me vitin 2013 pësoi rënie me 245 persona.

Popullsia më 1 Janar 2015 sipas qarqeve. Qarku me popullsinë më të lartë në Shqipëri mbetet Tirana me 800.986 banorë, e ndjekur nga Fieri me 315.012 dhe Elbasani me 301.397 banorë. Qarqet me popullsinë më të ulët në vend janë Gjirokastra, Kukësi dhe Dibra, respektivisht me nga 72.202, 85.461, 136.476 banorë. Nga të gjitha qarqet vetëm Tirana, Durrësi dhe Vlora kanë njohur rritje të popullsisë, ndërsa popullsia e të gjitha qarqeve të tjera ka pësuar rënie. Qarku me rritjen më të madhe të popullsisë është Tirana me një rritje vjetore prej 1,61 %, ndërsa qarku me rënien më të lartë të popullsisë është Gjirokastra me një rënie vjetore prej 1,84 %. Qarku me raportin gjinor më të lartë është Dibra me 106,6 meshkuj për 100 femra, ndërkohë që në qarkun e Tiranës ky raport është më i ulëti me 99,3 meshkuj për 100 femra.

Fig. 1 Piramida e Popullsisë, 1 janar 2015




Fig. 2 Lindjet, vdekjet dhe shtesa natyrore e popullsisë, 2001 - 2014




Fig. 3 Popullsia e Shqipërisë 2001 - 2015





Fig. 4 Koeficienti bruto i lindjeve sipas Qarqeve, 2014



Tab. 1 Popullsia sipas Qarqeve dhe gjinisë

Qarqet	1 Janar 2014			1 Janar 2015		
	MF	M	F	MF	M	F
Gjithsej	2.895.947	1.459.963	1.435.984	2.893.005	1.461.983	1.431.022
Berat	145.097	73.502	71.595	142.679	72.502	70.177
Dibër	138.321	70.919	67.402	136.476	70.418	66.058
Durrës	275.205	139.399	135.806	276.191	140.206	135.985
Elbasan	302.827	153.272	149.555	301.397	153.387	148.010
Fier	317.799	161.736	156.063	315.012	160.661	154.351
Gjirokastrë	73.556	37.470	36.086	72.201	36.755	35.446
Korçë	226.066	114.906	111.160	224.165	114.277	109.888
Kukës	86.472	43.870	42.602	85.461	43.520	41.941
Lezhë	138.214	69.631	68.583	136.814	69.280	67.534
Shkodër	221.235	110.461	110.774	218.523	109.202	109.321
Tiranë	788.330	392.273	396.057	800.986	399.157	401.829
Vlorë	182.825	92.524	90.301	183.100	92.618	90.482

Tab 2. Popullsia më 1 Janar sipas grupmoshës dhe gjinisë

	1 Janar 2014			1 Janar 2015		
	MF	M	F	MF	M	F
Gjithsej	2.895.947	1.459.963	1.435.984	2.893.005	1.462.005	1.431.000
0-4	172.517	89.420	83.097	172.429	89.287	83.142
5 - 9	166.011	87.690	78.321	165.849	87.232	78.617
10 - 14	216.490	112.159	104.331	199.650	103.743	95.907
15-19	256.553	130.580	125.974	251.456	128.477	122.979
20-24	229.529	124.336	105.193	228.255	122.882	105.373
25-29	210.828	114.197	96.632	210.752	116.178	94.574
30-34	191.899	94.949	96.950	195.241	98.762	96.479
35-39	176.492	84.005	92.487	175.960	84.336	91.624
40-44	186.144	88.592	97.552	182.425	86.922	95.503
45-49	197.530	95.598	101.932	194.961	94.344	100.617
50-54	210.688	104.619	106.070	211.418	104.236	107.182
55-59	189.265	94.245	95.020	194.670	97.033	97.637
60-64	143.754	72.518	71.235	149.719	75.032	74.687
65-69	108.400	54.945	53.455	115.335	58.117	57.218
70-74	104.307	50.427	53.881	104.316	50.932	53.384
75-79	73.204	36.096	37.108	76.077	37.239	38.838
80-84	39.003	17.350	21.653	41.876	18.800	23.076
85+	23.331	8.237	15.093	22.616	8.453	14.163

Metodologjia

Dinamikat e popullsisë përcaktohen nga katër faktorë: lindjet, vdekjet, imigracioni dhe emigracioni. Efekti i secilit prej faktorëve në numrin e popullsisë jepet në ekuacionin e bilancit të popullsisë:

$$P_{1 \text{ janar } 2015} = P_{1 \text{ janar } 2014} + L - V + I - E,$$

ku P_{2014} dhe P_{2015} janë respektivisht numri i popullsisë më 1 janar dhe

L, V, I dhe E janë lindjet, vdekjet, imigrantët dhe emigrantët në periudhën një vjeçare 1 janar 2014 – 31 dhjetor 2014.

Popullsia e Shqipërisë e llogaritur më 1 janar 2015 bazohet në përlogaritjen e kombinuar ndërmjet popullsisë më 1 Janar 2014 dhe ngjarjeve demografike (lindje dhe vdekje) që vijnë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Si pikënisje u mor popullsia në 1 Janar 2014 e disagreguar sipas moshës dhe gjinisë. Më pas, informacioni mbi lindjet dhe vdekjet sipas moshës dhe gjinisë përgjatë vitit 2014 iu shtua kësaj popullsie nga e cila përfuam një popullsi që merrte në konsideratë vetëm ndryshimin e saj nga shtesa natyrore. Përsa i përket emigracionit dhe imigracionit, ato u morën nga botimi “Projeksionet e Popullsisë 2011-2031”.¹ Informacioni mbi lëvizjet e brendshme u përdor vetëm për të llogaritur popullsinë sipas qarqeve.

Përkufizime

Piramida e Popullsisë: Është një lloj i veçantë grafiku bar që tregon përbërjen e popullsisë sipas moshës dhe seksit.

Projeksionet e Popullsisë: Janë llogaritje të ndryshimeve të ardhshme në numrin e popullsisë, pasi janë bërë supozime rreth tendencave të ardhshme në koeficientet e lindshmërisë, vdekshmërisë dhe migracionit.

Koeficienti bruto i lindjeve: Është numri i lindjeve për 1000 banorë të një territori në një vit të dhënë.

Vendbanues i zakonshëm: quhen vendbanues të zakonshëm të gjithë personat pavarësisht shtetësisë së tyre, të cilët jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë për të paktën 12 muaj ose që kanë qëllim për të qëndruar të paktën një vit.

¹ http://www.instat.gov.al/media/241768/projeksionet_e_popullsis_2011-2031.pdf